

Një ditë, Muhamedi salallahu alejhi ue selem ishte ulur me shokët e tij dhe i pyeti, duke filluar nga Ebu Bekri, Allahu qoftë i kënaqur me të.

“Çfarë do nga kjo botë?”

Ebu Bekri, Allahu qoftë i kënaqur me të, tha: “Unë dua nga kjo botë tri gjëra: uljen pranë teje, o i Dërguar i Allahut, të shikoj ty dhe dhënia e pasurisë (për atë që është e nevojshme për ta ndihmuar fenë e Allahut).

“Po ti, o Umer, çfarë do nga kjo botë?”

Umeri u përgjigj: “Nga kjo botë dua tri gjëra: urdhërimi në të mirë qoftë edhe fshehtas, ndalimi nga e keqja qoftë edhe e publikuar dhe fjala e drejtë qoftë edhe e hidhur.”

“Po ti, o Uthman, çfarë do nga kjo botë?”

Uthmani, Allahu qoftë i kënaqur me të, u përgjigj: “Dua nga kjo botë tri gjëra: dhënien e ushqimit, shpërndarjen e selamit dhe namazin natën kur njerëzit janë duke fjetur.”

“Po ti, o Ali, çfarë do nga kjo botë?”

Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me të, tha: “Dua nga kjo botë tri gjëra: nderimin e mysafirit, agjërimi gjatë ditëve të gjata të verës, goditja e armikut me shpatë.

“Po ti, o e Ebu Dherr, çfarë do nga kjo botë?”

Ebu Dherri, Allahu qoftë i kënaqur me të, tha: “Unë dua nga kjo botë tri gjëra: urinë, sëmundjen dhe vdekjen.”

Phoca PDF

Muhamedi sal Allahu alejhi ue selem e pyeti: “Pse i do këto gjëra?”

Ebu Dherri iu përgjigj duke i thënë: “E dua urinë që të më zbutet zemra. E dua sëmundjen që të më falen mëkatet. E dua vdekjen që ta takoj Allahun.”

E, në fund Muhamedi salallahu alejhi ue selem tha: “Kurse mua më janë bërë të dashura nga dynjaja juaj tri gjëra: era e mirë, parfumi, gratë (me kurorë në mënyrë ligjore) dhe më është bërë kënaqësia e shpirtit tim në namaz.”

Në atë çast zbriti Xhibrili u dha selam dhe tha: “Unë dua nga dynjaja juaj tri gjëra: transmetimin e shpalljes, kryerjen e amanetit, dashuria e meskinëve (të varfërve).”

Pastaj u ngrit në qiell dhe u kthye përsëri e tha: “Allahu i Lartësuar po ju përshëndet dhe po ju tregon se Ai do nga dynjaja juaj tri gjëra: gjuhën që shumë e përmend atë (bën dhikër shumë), zemrën që shumë ia ka frikën Atij dhe një njeri që bën sabër në bela (sprova).”

Përktheu: Hevzi Kadriu

Nga:muslim.net

Phoca PDF